



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 09 shtator 2020, në mbledhjen e XXXV (tridhjetë e pesë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës përveç z.Fitim Muçolli i cili mungoi, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave dhe OJQ-së SDK.

Rendi i Ditës

Dhënia e betimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Shaban Bajoku

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë ku sigurisht keni mund të shihni se është rekomanduar edhe 1 pikë shtesë, siç keni vërejtur në konstatime nga mbledhja e KPF-së.

Para se të fillojmë me punë rreth kësaj mbledhje, siç edhe jeni të informuar besoj, ish këshilltari i Kuvendit z.Bunjamin Hoti pas emërimit Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik më 03 gusht 2020, i njëjti ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e këshilltarit të Kuvendit.

Pas zhvillimit të procedurave përkatëse për zëvendësimin e anëtarit në fjalë, më 12 gusht 2020 KQZ me Vendimin nr.733/2020 ka bërë zëvendësimin e të përmendurit me z.Shaban Bajoku i cili është emëruar këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Sipas procedurave përkatëse ligjore anëtari i ri i Kuvendit duhet të bëjë betimin solemn para Kuvendit të Komunës, mirëpo paraprakisht kërkohet që të bëhet verifikimi i mandatit të këshilltarit në fjalë, andaj ftoj komisionin në përbërje z.Avni Fetahu, znj.Doruntinë Hasani dhe z.Fatmir Rudari të merret me këtë çështje, dhe të na paraqesin raportin përkatës.

znj.Doruntinë Hasani, në emër të Komisionit e paraqiti raportin në fjalë, theksoi, bazuar në Vendimin e KQZ-së z.Shaban Bajoku emërohet anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit të Komunës z.Bunjamin Hoti.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar komisionin në fjalë për paraqitjen e raportit ftoi z.Shaban Bajokun që të ngritët dhe me tekstin si në vijim ta bëjë betimin, pra unë e lexoj pjesë kurse ju e përsëritni atë me të vetmin plotësim që në fillim ta cekni emrin dhe mbiemrin e juaj.

Me tekstin si në vijim;

“Unë Shaban Bajoku betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”

Kryesuesi i Kuvendit, duke e falënderuar këshilltarin e ri të Kuvendit të Komunës z.Shaban Bajoku, nënvizoi, nga tani zyrtarisht jeni këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës në këtë mandat, me të gjitha të drejtat dhe detyrat përkatës, për çka të dëshiroj suksese dhe punë të mbarë. E konsideroj të mbyllur këtë proces dhe vazhdojmë me punë, me rendin e ditës, urdhëroni nëse ndokush ka diçka.

z.Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me rendin e ditës, përkatësisht me pikën 3 propozim Kodit Etik për të cilin unë mendoj se është mirë të hiqet nga rendi i ditës për këtë mbledhje, për këto arsye, dhe atë, jeni në dijeni që Ligji nr.06/L-111 që ka të bëjë me pagat, nga Gjykata Kushtetuese është nxjerrë aktgjykimi sipas të cilit ai Ligj është rikthyer në Kuvendin e Republikës së Kosovës sepse janë gjetur të meta nga Gjykata Kushtetuese dhe si i tillë nuk mund të zbatohet.

Po ashtu edhe Ligji 06/L-114 për zyrtarët publik, nga gjykata Kushtetuese me aktgjykimin nr.209 të datës 20 korrik 2020 është kthyer për rishqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës sepse ka rënë në kundërshtim me Kushtetutën. Kështu që asnjë akt nënligjor, siç është ky Kod i Etikës të cilin Ministria e Pushtetit Lokal ju ka dërguar Komunave, por edhe në nenin 2 të këtij propozim Kodi është paraparë se është bërë në pajtim me Ligjin për zyrtarët publik, kështu që mendoj se çështja e miratimit të këtij propozim Kodi i Etikës është e paligjshme dhe e paqëndrueshme që ne sot ta procedojmë sepse nuk mund të dalim kundër një vendimi të gjykatës Kushtetuese, prandaj kjo është arsyetimi. Pastaj mendoj se nuk mbetemi keq edhe pa këtë sepse është Kodi i mirësjelljes për nëpunësit civil në Shërbimin Civil nr.04/2015 i paraprirë nga ai 01/2006 dhe normalisht është edhe një kod i pashkruar që duhet udhëheqë administratën secili dhe sigurisht ato gabime, ato lëshime, ato shkelje, ato vepra penale dhe të gjitha të tjerat sigurisht që mund të ndalen edhe pa Kod të Etikës.

Kështu që unë propozoj të pezullohet miratimi i këtij propozim Kodi sepse bie ndesh me bazën ligjore dhe Kushtetuese, por nëse ju me kokëfortësi vazhdoni atëherë mbetet çështje e juaja mirëpo Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së nuk do ta votoj këtë, për këto arsye që unë i ceka.

Fatkeqësisht kemi theksuar disa herë që profesionalizmi i kësaj Komune, efikasiteti dhe eficiency, zbatimi i ligjit dhe procedurave nuk është në nivel dhe kjo u dëshmuar me sjelljen për miratim të këtij propozim Kodi të Etikës para asamblistëve të Kuvendit.

z.Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, theksoi, lidhur me atë që këshilltari parafolës e ngriti rreth këtij propozim Kodi Etik është e vërtetë që është një Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për zyrtarët publik që iu referuar zotëri Ajeti, por sa jam në dijeni unë ai Ligj nuk është deroguar në tërësi por vetëm në disa pjesë të tij. Deri më tani nga Ministria e Pushtetit Lokal si Ministri e linjës nuk kemi ndonjë udhëzim të qartë në lidhje me këtë çështje, dhe ky propozim Kod Etik, i mirë apo i keq, është model i kësaj Ministrie për të gjitha Komunitetet e Kosovës, dhe nuk është që vetëm Komuna e Podujevës ka hartuar një model të tillë, ndërsa rreth asaj që a duhet ta kemi një Kod të tillë mendoj se patjetër duhet ta kemi, ndërsa kujt i referohet është specifikuar mjaft mirë në vet këtë propozim Kod.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj që është e paqëndrueshme ajo që e tha drejtori parafolës sepse Ligji kur të kthehet sigurisht që do të ketë ndryshimet e nevojshme të cilat edhe i ka propozuar Gjykata Kushtetuese, po nisem vetëm nga një shembull, ju keni futur në Kod se të gjithë duhet ta respektojmë, edhe nëpunësit publik edhe zyrtarët politik, do të thotë, të gjithë të punësuarit në

Komunë gjë e cila është gabim sepse edhe Ligji 06/L-114 ka ndarë edhe shërbyesit civil edhe zyrtarët publik, dhe unë mendoj se me ndryshimin e ligjit në fjalë që do të bëhet nga Kuvendi i Kosovës do të ndryshoj edhe pozicioni i neneve dhe paragrafëve përkatëse. Andaj nëse ju jeni bazuar në shkresën e muajit shkurt-mars që ju është dërguar nga Ministria është dashur të komunikoni sërish kur keni parë Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese se cilat janë pasojat.

Unë kam bindjen se do të bëjmë gabim, përndryshe nëse ju dëshironi të veproni prej gabimeve në gabime urdhëroni veproni, ju e dini më së miri.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nëse shkresa e MPL-së ka ardhë në muajin shkurt dhe para dërgimit të Ligjit në fjalë në Gjykatën Kushtetuese dhe Komuna është vonuar në procedim, mendoj se duhet të shqyrtohet kjo çështje. Se a duhet ta kemi një Kod Etik se si të sillemi secili zyrtar publik jam për, sepse secili prej nesh është mirë të sillemi sipas rregullave dhe në mënyrë sa më njerëzore sa i përket gjuhës dhe gjërave tjera eventuale, mirëpo nëse shkresa ka ardhë prej MPL-së e cila edhe vendimin e këtij Kuvendi e procedon për vlerësim të ligjshmërisë, pozitiv apo negativ është çështje tjetër. Pra mendoj se në aspektin administrativ është mirë ta shikoj edhe njëherë Drejtori i Drejtorisë së Administratës, të komunikoj edhe njëherë me zyrtarët përkatës të Ministrisë përkatëse, nëse është vonuar me procedim të këtij dokumenti ta potencon këtë. Kjo mos të merret që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së po dëshirojmë t'i ikim miratimit të këtij Kodi, përkundrazi, madje edhe nëse e miratojmë këtë dokument dhe nëse i njëjti është në kundërshtim me Ligjin për zyrtarët publik dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese sërish do të kthehet si i jashtëligjshëm nga Ministria ashtu siç ka vepruar në disa raste, edhe pse nuk ka sanksionim dhe procedim penal për Kuvendin në raste të tilla, por nëse ka çështje diskutabile është mirë të mos veprojmë me vetëdije diçka që mund të mos jetë në rregull.

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, theksoi, sa për sqarim, është e vërtetë se shkresa e MPL-së ka ardh më 06.02.2020, por më 26/27 qershor 2020 kemi pranuar e-mail prej MPL-së me të cilën dërgohet edhe modeli i këtij Kodi. Pra pas muajit shkurt MPL ka formuar një Grup punues për hartimin e model Kodi të Etikës të cilin pastaj e kanë dërguar në të gjitha Komunat, dhe bazuar në atë model i cili ka ardhë në muajin qershor ne e kemi përshtatur këtë propozim të cilin e keni para vetës dhe të njëjtin e kemi proceduar.

Kryesues i Kuvendit, e vë votim propozimin e këshilltarit z.Bajram Ajeti, për heqjen e pikës 3 nga rendi i propozuar i ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton që nuk miratohet propozimi për heqjen e pikës 3 nga rendi i propozuar i ditë për shkak se vetëm 8 vota ishin për, kurse tjerat ishin kundër.

Kryesues i Kuvendit, e vë në votim propozimin e rendit të ditës së bashku me konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton që me shumicë të votave (22 për) u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së dhe pikën shtesë, dhe atë;

- **Propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së futbollit Kosovar Fadil Vokrri** (E cila hyn në pikën 4 të rendit të ditës kurse pika Të ndryshme kalon në pikën 5)

**1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:
30 qershor 2020, 24 korrik 2020 dhe 29 korrik 2020**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç edhe keni mund të shihni në materialet e kësaj pike, kemi 3 Ekstrakte të procesverbaleve të tri mbledhjeve të fundit të Kuvendit të Komunës, andaj urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë vërejtje apo ndonjë plotësim ndryshim eventual, nëse jo i hedh në votim, në pako.

Pas votimit u konstatua se njëzëri, pa vërejtje, korrigjime, apo plotësim ndryshime u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve sipas kësaj pike të rendit të ditës.

2. Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

➤ **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik**

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës kemi këtë propozim Rregullore e cila në fakt është propozuar për vënie në diskutim publik, dokument i cili është hartuar në bazë të Udhëzimit të ri Administrativ MAPL 02/2019.

Diskutimi publik duhet të mbahet brenda 30 ditëve dhe për këtë kemi menduar që të vëhet nga 14.09.2020 deri më 15.10.2020 në mënyrë që për seancën e muajit tetor të jemi të gatshëm për miratim të kësaj Rregulloreje mirëpo pavarësisht kësaj unë kam menduar që datat e sakta të diskutimit publik dhe debateve publike dhe mënyrën e mbajtjes së tyre është mirë t'i caktojmë bashkërisht në këtë mbledhje sepse siç jemi në dijeni duhet ta kemi parasysh edhe situatën e pandemisë. Drejtoria e Administratës jemi të gatshëm për debate publike kurdo që Kuvendi vendos për të mbajtur ato, por që duhet pasë parasysh që debatet publike duhet të jenë brenda kohëzgjatjes së diskutimit publik.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kemi të bëjmë me një Rregullore respektivisht vënien e saj në diskutim publik, por që unë kam vetëm një vërejtje sa i përket funksionalizimit të trupave sepse këshillat e fshatrave parashihen të jenë në disa raste 4 fshatra ose më shumë por sa do të jetë e mundshme që në praktikë të funksionoj kjo është temë tjetër, gjithnjë duke e kuptuar që kemi të bëjmë me një Udhëzim Administrativ i cili duhet të respektohet.

Pastaj në nenin 15 të dokumentit në fjalë kemi kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale ku thuhet, për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës së Podujevës dhe atë në shumë ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative.

Pra në këto dy pika unë e shohë që mund të ketë probleme në funksionalizimin e këshillave sepse shembull, në nenin 4 kemi fshatrat (Obrançë, Peran, Bradash, Dobratin) e që në vijë gjeografike është goxha problem, dhe që ne nuk mund t'i ikim edhe asaj kulturës që kemi.

Për çështje tjera ky draft do të vëhet në diskutim publik dhe do të mbahen debate publike ku do të jepen vërejtje, sugjerime, këshilla dhe rekomandime të ndryshme, andaj Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështet këtë propozim Rregullore për vënie në diskutim publik.

z.Bajram Ajeti, theksoi, fillimisht prita nga drejtori i DA-së që të kërkoj falje për dështimin që ta sjellë një rregullore të tillë sepse ka 2 vite që është vonuar kur jemi në dijeni se më 31 korrik 2018 ka qenë në rend të ditës në Kuvend dhe është miratuar, është vënë në diskutim publik, është mbajtur edhe debati publik, pastaj në vitin 2019 është nxjerrë Udhëzim i ri Administrativ nga MAPL sipas të cilit obligohet pastaj që Rregulloret aktuale të Komunave, duke konsideruar që veç janë të kryera sipas Udhëzimit Administrativ 2008/08, që të bëhen plotësim ndryshimet përkatësisht harmonizimet

sipas Udhëzimit të ri, prandaj e them se ka qenë e ndershme të kërkohet falje nga drejtori dhe të tregoj përse. Unë kam bindjen se ju keni dashtë të vazhdoni në mënyrë të paligjshme me udhëheqës të emëruar të fshatrave dhe të pazgjedhur dhe atë në mënyrë arbitrare ngase janë edhe kryetar të fshatit edhe kryetar të nëndegës, mirëpo më mirë vonë se kurrë dhe më vie mirë që tani është sjellë kjo propozim Rregullore e cila është e domosdoshme dhe paraprakisht është obligim ligjor dhe sa është nevoja që fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ta kenë një strukturë që të merren me disa kompetenca vetanake që ka Komuna siç janë edhe në këtë draft Rregullore por që janë shumë pak, madje vërejtja (kanalizimi, uji, drenazhimi) por që do të thoja se më mirë do të ishte të thuhej infrastruktura sepse zakonisht tek asfalti lidhet shumë, e që po e theksoj një rast frik (po i them njërit sa po e bëni të trash, më tha 7 cm, i thash por kur po e shtypni po vie në 4 cm, më tha ajo e para numërohet). Kështu që unë mendoj se kompetencat vetanake që janë të Komunës ka qenë mirë të përfshihen në këtë dokument dhe shumë fusha tjera që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve.

Janë paraparë 6 këshilla urbane e që unë mendoj se duke marrë për bazë këshillat e fshatrave që janë grupuar ashtu siç e ngriti edhe këshilltari paraprak zotëri Ajeti, dhe duke marrë për bazë dendësinë e fshatrave dhe të qytetit ndoshta do të ishte mirë të reduktohej numri i këshillave në qytet dhe të shtohet në fshatra ngase konsideroj se është ndoshta e palogjikshme që shembull, fshati Metehi të mos ketë këshill të veçantë, pastaj fshati Kërpimeh përse të mos jetë me Pakashticë të Epërme dhe Pakashticën e Poshtmen, mandej fshatrat Obrancë, Peran, Bradash, Dobratin janë fshatra të mëdha, Llapashtica e Poshtme dhe Llapashtica e Epërme, emri Velikarekë të hiqet dhe të emërtohet ashtu siç njihet në popull Katunisht, pastaj Gllamnikun e keni lënë vetëm, kurse fshatrat Shajkoc dhe Dumosh nuk mund të shkojnë të dyja bashkë të jenë në një këshill lokal sepse pastaj na paraqiten probleme kur të bëhen këshilla ngase janë fshatra të mëdha dhe nuk do të pajtohen në çështje të ndryshme mes vete. Mandati i kryetarit të këshillit sipas Udhëzimit Administrativ 02/2019 është 4 vite, kurse në këtë propozim Rregullore është shtuar edhe, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat e që unë do të doja të respektohet Udhëzimi, pra të jetë 4 vite sepse pastaj ata kryetar të këshillave do të mund të ndikohen nga secila administratë komunale që do të vie në pushtet në të ardhmen.

Po ashtu pajtohem me shqetësimin e këshilltarit parafolës z.Hasan Ajeti rreth çështjes së kompensimit të kryetarit të këshillit e që unë mendoj se nuk është dashur të përfshihet vetëm kryetari i këshillit por të përfshihen kryetari dhe anëtarët e këshillit dhe kam bindjen që Komuna ka mundësi për një kompensim të tillë ngase mendoj që motivi i tyre, efikasiteti, eficientia e tyre për tu marrë me problemet që janë për ato këshilla pastaj janë më serioze, pra propozoj të mos ndahen anëtarët e këshillave nga kryetari i këshillit sa i përket kompensimit.

Tek çështja e raportimit, konsideroj se është lënë në një mënyrë që Kuvendit të Komunës të mos jepet raport por është lënë Kryetarit të Komunës, kurse çfarë Kryetari të Komunës kemi pas dhe çfarë kemi aktualisht një të tillë i cili po vazhdon me praktikën e njëjtë, nuk vie në mbledhje, nuk raporton kurrë edhe pse e obligon ligji për të raportuar çdo 6 muaj, prandaj mendoj se meqë komisionin për zgjedhjen këshillave lokale po e cakton ky Kuvend atëherë të gjendet mënyra që qoftë përmes Kryetarit të Komunës apo formave tjera këshillat t'i raportojnë Kuvendit të Komunës.

Më vie mirë që anëtar në komision të ketë edhe nga Shoqëria Civile dhe do të doja që vërtetë të jenë OJQ të cilat vërtetë janë të pavarura, nuk janë “zorë qorre” siç ka ndodh deri tani duke marrë buxhet dhe duke shfrytëzuar atë përmes donacioneve por të jenë vërtetë ato që merren me hallet e qytetarëve, ngase 320 OJQ të ketë Llapi vërtetë është e pamundur të besohet, por vetëm shfrytëzohen për fushata etj etj.

Ne Grupi i LVV-së do ta votojmë që ky propozim të vëhet në diskutim publik dhe kërkojmë që diskutimi dhe debatet publike të organizohen dhe mbahen në afatin sa më të shkurtër, por jo debat sikurse herën e kaluar ku kam qenë prezent e që janë thirr kryetarët e katundeve, pra ju lutem të

thirren qytetarët dhe të bëhet sa më transparent ftesa duke marrë për bazë mënyrat dhe teknikat siç janë përcaktuar në vet këtë propozim Rregullore, pra të mbahen sa më shumë debate dhe të ketë prezencë sa më të madhe të qytetarëve në mënyrë që vërtetë në fund të jetë një rregullore e mirë dhe ta kuptojnë edhe qytetarët se për çfarë ka të bëjë kjo Rregullore dhe ku është interesi i tyre.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim propozim Rregulloren në fjalë edhe pse e vonuar besojmë se është e nevojshme.

Dilemat tona kryesisht janë të njëjta me ato të parafolësve, përkatësisht tek numri i këshillave e që unë kërkoj sqarim nga drejtori i DA-së se a ka mundësi të rritet numri i këshillave, e them këtë duke u bazuar edhe në një debat të thirrur nga shoqëria civile ku zyrtari përkatës si përfaqësues i Komunës në atë takim e bëri një propozim që të jenë 52 këshilla lokale/urbane e që siç e potencoi ai do të ishte ideale dhe do të përfshiheshin të gjitha fshatra dhe vendbanimet në mënyrë pak më specifike.

E them këtë sepse nganjëherë duke u munduar të bëjmë mirë mund të ndodh të bëjmë keq në disa situata ngase janë paraparë që në një këshill të jenë 4-5 fshatra të mëdha dhe sigurisht që do të ketë mospërputhje dhe ngatërresa mes tyre kështu që ne si Kuvend i Komunës është mirë që ta definojmë këtë punë, përndryshe jemi për që kjo propozim Rregullore të procedohet tutje për diskutim publik kurse për datat e diskutimit publik dhe mbajtjes së debateve publike pajtohemi qoftë për ato që u jepen qoftë edhe tjera, vetëm të saktësohen.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në aspektin administrativ ky dokument nuk është fuqiplotë por i njëjti po procedohet për diskutim publik dhe debate publike me qytetarë ku do të jepen idetë dhe propozime konkrete, mirëpo mandati jonë si anëtar të Kuvendit është në përfundim dhe ndoshta as pjesë të komisionit përkatës nuk do të mund të jemi por do të lëmë/trasojmë një dokument të rëndësishëm për Kuvendin e ardhshëm të komunës, e them këtë për shkak se konsideroj se as tubimet publike nuk do të mund të mbahen për shkak se jemi në situatë pandemike, mirëpo si dokument është mirë të procedohet dhe të miratohet.

Sa i përket prononcimit të zyrtarit të Komunës për bashkëpunim me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, meqë ai është zyrtar i Komunës më mirë do të ishte që ai para se të hartohet ky dokument t'ia dërgonte propozimin e tij që të jenë 52 këshilla po që se ai mendon se është më mirë, e jo në këtë formë sepse tani ne jemi në konfuzitet ngase personi kompetent e potencon se më mirë është të jenë 52 këshilla kurse në dokument figurojnë vetëm 30.

Te çështja e ndarjes gjeografike të këshillave të fshatrave edhe unë e shohë se do të ketë vështirësi në implementim apo në mbajtjen e kuvendeve zgjedhore sepse shembull, kemi nga 3-4 fshatra të parapara në një këshill lokal dhe sigurisht që Komisioni do të jetë konfuz qysh në vendin se ku do të mbahet tubimi zgjedhor, ta zëmë kemi Obrançë, Peran, Bradash, Dobratin dhe shtrohet pyetja se ku do të mbahet tubimi zgjedhor dhe është e nënkuptueshme që aty ku mbahet tubimi pjesëmarrja e atij fshati sigurisht që do të jetë më e madhe (nuk mund të jetë pjesëmarrja e Obrançës më e madhe se ajo e Dobratinit nëse tubimi mbahet në Dobratin) pra jam duke fol për fshatra të mëdha jo për këshilla lokale për ndonjë fshat që ka 5-6 shtëpi. Pra kjo konsideroj se do të jetë paksa më problematike por mbetet detyrë e komisionit përkatës se si do të rregulloj këtë çështje.

Çështja tjetër, nga tani po kërkoj, ende pa u miratuar dokumenti në fjalë dhe ende pa u ngritur komisioni i cili do ta implementoj dhe do të funksionalizoj këshillat këtë dokument, anëtar i komisionit nga shoqëria civile që parashihet të jetë, të mos propozohet askush pa procesverbal të takimit të OJQ-ve, përndryshe do të jem kundër, kohë ka për tu përgatitur shoqëria civile dhe për të mbajtur takim, ta sjellin procesverbalin dhe të propozuarin e tyre pastaj ne vendosim për atë e jo të ndodh sikurse që ishte propozimi i anëtarit nga këshilli i prindërve për anëtar i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, pa kurrfarë procesverbali dhe pa kurrfarë dokumenti e që ka shumë ankesa të prindërve sepse askush nuk qenë në dijeni por vetëm

drejtori i DKA-së i ka thënë të vie e që nuk jam kundër tij/saj sepse ndoshta ai sërish do të propozojë në atë komision por është mirë të ndiqen hapat që na takojnë.

Jemi në situatë pandemie dhe nuk besoj se do të organizohen dhe funksionalizohen këshillat në një kohë të shpejtë por dokumenti është mirë të miratohet, si dhe kërkoj nga të gjitha subjektet politike në këtë Kuvend që të gjitha këto vërejtje, dilema, propozime të futen në një dokument nga secili prej nesh dhe pastaj të paraqesim në debat publik dhe nëse ka hapësirë mandej të inkorporohen.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, duke qenë të gjithë të vetëdijshëm për rendësin e kësaj Rregulloreje, për ta pasur edhe më herët por njëkohësisht edhe faktin që kjo pastaj t'i nënshtrohet një debati të gjerë shpresoj ku do të ketë mundësi të pasurohet prap se prap besojmë që kontura kryesore është kjo, andaj desha që të vë 2-3 theksime të cilat në pamje të parë ndoshta duken teknike por që disa nga ato ndoshta e determinojnë edhe anën përmbajtësore, tek neni 3 pika 4 ku shkruan për përfaqësimin e komisionit e që flitet për një anëtar që vie nga fshati, lagja apo zona ku mbahet debati unë do të veja theksin në këtë që t'i kushtohet kujdese dhe të sqarohet sakt se si do të zgjedhet ai anëtar për shkak se shtu këtu faktin për shqetësimin që u ngrit nga të gjithë se do të ketë më shumë fshatra dhe do të jetë më i vështirë koordinimi dhe në këtë pikë do të haset edhe problemi kryesor andaj të përcaktohet qartë se në çfarë mënyre do të zgjidhet përfaqësuesi i lagjes, fshatit apo vendbanimit ku do të mbahet takimi dhe nga i cili do të jetë anëtar i Komisionit në fjalë, pastaj tek neni 10 është një çështje teknike që besoj se nuk është e nevojshme të jenë dy pika (turizmit/zhvillimi i turizmit), çështje teknike kjo por që njëkohësisht e tregon edhe profesionalizmin e që mendoj se do të ishte mirë të jetë turizmi dhe zhvillimi i tij, ose diçka e tillë. Si dhe te kompensimi çështje të cilën e ngritën edhe kolegët tjerë parafolës, besoj se do t'i kushtohet kujdes i veçantë dhe do të del një propozim konkret dhe më i mirë i mundshëm nga debatet që do të mbahen por prap se prap mendoj se neni 15 pika 2, fjalia nuk qëndron si e tillë dhe pavarësisht modalitetit që do të zgjedhet besoj se do të duhet të shkruhet, kompensimi bëhet për më shumë se deri në 6 mbledhje, ose diçka e tillë pra të riformulohet qartë.

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, theksoi, sa i përket asaj që u fol për numrin e këshillave, nuk e di se çfarë është diskutuar nëpër debate të ndryshme sepse isha në pushim dhe nuk kam mundur të jem prezent mirëpo Udhëzimi Administrativ, neni 4 paragrafi 2.6 decidivisht e potencon se për Komunitat të cilat kanë prej 70 mijë deri në 100 mijë banorë Komuna duhet t'i ketë deri në 30 këshilla, pra jemi të vetëdijshëm se mund të ketë telashe por kemi një akt juridik që e rregullon përkatësisht e kufizon këtë andaj për mua në cilësinë e një juristi ana ligjore është më e fortë se ana politike, mirëpo me gjithë dëshirën që të kemi qoftë që të kemi 52 këshilla apo ndoshta secili fshat ta ketë kryetarin dhe këshillin e vet, Udhëzimi Administrativ përkatës i nxjerrë nga MAPL nuk na lejon t'i kemi më shumë se 30 këshilla lokale, pra mund ta kemi 1 këshill në tërësi por mund të kemi edhe 30 të tillë, prandaj kufizimi ligjor për themelimin dhe organizimin e këshillave lokale për Komunitatën e Podujevës e cila sipas numrit të popullsisë prej 70 mijë deri në 100 mijë banorë është deri në 30 këshilla e që është kufizim ligjor dhe nuk mund të anashkalohet edhe përkundër dëshirës tonë e që nuk mund të tejkalohet me Rregulloren përkatëse nga ne si Komunitatë ngase kemi Udhëzimin Administrativ i cili rregullon këtë çështje dhe i cili patjetër që duhet të respektohet.

Sa i përket kompensimit, po ashtu te neni 12 i Udhëzimit të cekur flitet vetëm për kompensimin e kryetarëve të këshillave, citoj, *kompensimi për kryetarët për pjesëmarrje në takime bëhet vetëm për 6 takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik*, mirëpo ne do të shohim mundësi tjera sepse është neni 13 në të cilin flitet për financimin e aktiviteteve kështu që bashkërisht edhe gjatë debatit publik dhe gjatë debateve të brendshme që do të kemi besoj se do të gjejmë një modalitet se si të ecim para, mirëpo e përsëris që, neni 12 i Udhëzimit Administrativ decidivisht e thekson vetëm

kompensimin e kryetarëve të këshillave lokal dhe atë deri në 6 takime të mbajtura të këshillit gjatë vitit kalendarik, pra kështu rregullohet me akt juridik të nxjerrë nga niveli qendror.

Sa i përket ndarjes apo përfshirjes së fshatrave në këshilla përkatëse lokale ne fillimisht jemi munduar të jemi sa më afër mes vete në bazë të shtrirjes gjeografike, pastaj planifikimet sipas Hartës Zonale janë marrë si kriter për ndarjen e këshillave urbane në qytet sipas të cilës qyteti ndahet në 6 zona, kurse për fshatra kemi marrë për bazë kriterin kadastral.

Sa i përket caktimit të datave të mbajtjes së debateve publike dhe kohëzgjatjes së diskutimit publik për këtë propozim Rregullore unë për hir të transparencës dhe kolegjalitetit e kam lënë të hapur që të propozohen dhe caktohen këtu në Kuvend por deri tani nuk pati një propozim të tillë nga ana juaj si Kuvend e që sërish e lë të hapur që kurdo që pajtoheni si Grupe të këshilltarëve urdhëroni caktoni brenda kohëzgjatjes së diskutimit publik, por pavarësisht kësaj si propozim mund të jetë që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë kurse data e mbajtjes së debatit publik mund të jetë 15 shtator 2020, mirëpo duhet pasur parasysh që për shkak të pandemisë mund të paraqiten probleme rreth debateve publike sepse siç jeni në dijeni parashihen kufizime sa i përket tubimeve.

edhe një gjë, e-maili i Drejtorisë së Administratës është i publikuar në veb faqe zyrtare të komunës dhe ju lus që qo propozim apo çfarëdo që keni mund të dërgoni dhe bashkërisht me ju dhe ekipën do të shqyrtohen të gjitha ato.

Për shkak të pandemisë propozoj që të mbahen tri takime dhe atë në tri data 15, 22 dhe 28 shtator 2020 nga ora 10:00 në këtë sallë ku jemi.

z.Bajram Ajeti, theksoi, ndoshta shumë më demokratike dhe shumë më e efektshme për të nxjerrë një Rregullore e cila në të ardhmen do të jetë funksionale e që është shumë me rëndësi sepse nuk është në pyetje vetëm organizimi apo struktura, andaj mendoj që tri debate janë shumë pak sepse kemi 30 këshilla të fshatrave që parashihen të themelohen prandaj debatet publike do të ishte mirë të mbaheshin në terren nëpër fshatrat përkatëse në mënyrë që ta kryejmë punën vërtetë mirë e jo vetëm sa për të thënë ose sa për ta bërë një dokument, mendoj që bile në fshatrat e mëdha siç i kemi të renditura në propozim Rregullore të organizohen, e jo vetëm tri debate sepse janë shumë pak, madje qysh tani unë po paragjykoj se këto çështje do të kalojnë aq në mënyrë fiktive sa që pastaj unë kam friken se për funksionalizimin e këshillave lokale pastaj do të na paraqiten probleme.

Pra mendoj se është mirë të organizohen më shumë debate publike, posaçërisht aty ku parashihen më shumë fshatra në një këshill lokal apo në fshatra të mëdha dhe që ka numër të madh të qytetarëve, por që ashtu siç u propozua të mbahen vetëm tri janë shumë pak.

Propozojmë që të mbahen të paktën 15 debate publike në ato këshilla që parashihen më shumë fshatra në ato pjesë që përmbushin edhe elementet përkatëse dhe kompaktësinë territoriale dhe mos të ngutemi dhe ta kemi deri diku edhe pëlqimin e të gjitha subjekteve dhe të heqim dilemat sa i përket asaj se a do të pajtohen fshati me fshat që të jenë në një këshill si dhe çështje tjera të cilat mund të jenë problematike.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, për numrin e takimeve pajtohem me parafolësin, por propozoj që edhe ora e takimeve të mos jetë ora 10:00 sepse është e pamundur të jetë pjesëmarrja e madhe e qytetarëve duke marrë parasysh që edhe është ditë pune edhe paksa herët e sidomos nëse preken edhe çështjet gjinore ku pastaj grat dhe vajzat e kanë të pamundur të marrin pjesë në debate në ora 10:00, andaj kërkoj të caktohet një orë tjetër më e përshtatshme për të gjithë dhe që pjesëmarrja të jetë sa më e madhe për shkak se 30% e këshillave është e detyrueshme që të jenë gra dhe vajza andaj mos të jepet shembull i keq sikurse në Ekzekutivin e Komunës që nuk ka të emëruara.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, është e vërtetë që sa më shumë tubime që mbahen është më mirë por është problem që në këtë kohë nuk guxon të thërret tubime/debate publike askush sepse jemi në situatë pandemie dhe është e ndalueshme rreptësisht mbajtja e tubimeve të tilla, pra nuk ka zyrtar

komunal që mund të thirrë tubime publike nëpër shkolla pa masa mbrojtëse dhe nuk e di se kush e merr atë përgjegjësi, kurse në këtë sallë dhe objekt institucional edhe mund të thirren por që duhet t'iu sigurohen masat mbrojtëse (maska, dezinfektues, distancë etj).

Në parim pajtoj të mbahen sa më shumë debate publike, qoftë 15 qoftë 20 e më shumë, por jo të mbahen tubime nëpër lokalitete sepse nuk kemi të drejtë dhe nuk mund të sigurohen masa mbrojtëse nëpër shkolla të lokaliteteve të ndryshme, përndryshe nëse veç dëshironi mbajtjen e tubimeve të tilla nëpër lokalitete atëherë i mbajmë por fillimisht të sigurohen masa mbrojtëse dhe hapësirë e nevojshme për mbajtjen e distancës, andaj të mos jepen propozime vetëm ashtu sepse më mirë të mbahen 3-4 tubime ashtu siç duhet se sa 15 apo 20 siç nuk duhet.

Në fakt debatet publike gjithherë janë mbajtur nga 1 dhe tani u propozuan 3 të tilla nga drejtori i DA-së dhe më vie mirë për këtë, madje në situatë jo të zakonshme si shkak i pandemisë, madje edhe nëse krejt puna nëse kryhet konsideroj që pastaj nuk do të mund të mbahet asnjë tubim zgjedhor nëpër lokalitete për themelimin e këshillave përkatëse sepse nuk di se kush i jep të drejtë ndokujt të thërras në tubim banorët e fshatrave përkatëse dhe të zgjedh këshillin dhe kryetarin e këshillit përkatës në kohë pandemie, prandaj të mos ngutemi me propozime sepse pastaj po dalim si shaka, përndryshe vëjeni në votim për diskutim publik këtë propozim Rregullore, kushdo që ka vërejtje, propozime apo sugjerime para miratimit final mund t'i jap, andaj të mos e zgjatim më shumë këtë çështje, përndryshe nëse ndokush dëshiron të bëjë shkelje ligjore duke e ngritur dorën dhe mbështetur që të mbahen tubime publike nëpër lokalitete të ndryshme, urdhëroni bëjeni.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, deri tani lidhur me këtë propozim Rregullore, përkatësisht propozim vendim për vënie në diskutim publik të draft Rregullores në fjalë kemi dy propozime, atë të drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe atë të këshilltarit z.Bajram Ajeti.

Pavarësisht që unë nuk mund të interferoj në çështjen e votimit, sa jam në dijeni unë debatet përkatësisht tubimet e qytetarëve janë të ndaluara në këtë kohë dhe situatë që jemi, andaj duhet shikuar mirë se si po veprojmë.

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, konsideroj se pjesa e debateve dhe tubimeve publike është e ndaluar me ligj dhe nuk kemi të drejtë të organizojmë tubime, madje edhe sot në këtë mbledhje të Kuvendit ku distanca nuk është e mjaftueshme e që biejm ndesh me Ligjin përkatës të miratuar në Kuvendin e Kosovës, mirëpo janë mundësitë tjera rreth mbajtjes së debatit publik (përmes e-maileve, ueb faqes zyrtare të komunës etj) ku njerëzit mund të paraqesin vërejtjet, propozime sugjerime dhe kontribute tjera lidhur me këtë draft Rregullore. Pra unë personalisht nuk do të organizoja asnjë debat/tubim publik sepse është ndesh me Ligjin dhe askush nuk merr përsipër pastaj nëse ndodh të kemi infektime apo shpërndarje të infeksionit të Covid-19, mirëpo debatet do t'i organizoja përmes sistemit elektronik.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, po e shohë këtu që paksa po shfrytëzohet edhe pandemia edhe pse tani së fundmi numri i rasteve është në rënie dhe nuk ka ndërprerje të punëve, por unë besoj që nëse ekziston vullneti edhe tubimet/mbledhjet mund të mbahen, koha nuk është e ftohtë, një migrofon me një zmadhues të zërit dhe tubimet mund të mbahen në oborre të shkollave, pra nuk e shoh problem nëse veç ekziston vullneti për mbajtjen e mbledhjeve/tubimeve.

z.Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, sqarim parafolëses, edhe njëherë ta kemi të qartë, aktualisht nuk lejohet me ligj që të ketë organizime të tilla, madje ndalohen tubimet mbi 5 persona.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pas këtij debati dhe diskutimeve të disa këshilltarëve, vërehet se nuk ekzistojnë mundësitë që të mbahen debatet e propozuara nga ana e drejtorit të Drejtorisë përkatëse, po ashtu u sqarua nga drejtori i DPUMM se kemi pengesa ligjore sa i përket mbajtjes së tubimeve dhe përgjegjësiive pastaj se kush do t'i merr. Prandaj të gjithë mund të konstatojmë se mundësitë për

mbajtjen e debateve ashtu siç parashihet me legjislacion dhe me vet këtë propozim Rregullore nuk ekzistojnë dhe për këtë jemi të gjithë të vetëdijshëm.

Propozim i imi është që organizmi i debateve dhe i diskutimit publik të suspendohet për një periudhë të caktuar, pra drejtori i DA-së mund të analizoj këtë çështje më mirë, por nëse mendohet që debatet të organizohen përmes tubimeve kështu siç jemi ne sot këtu konsideroj se nuk janë mundësitë ligjore, ndërsa sa i përket asaj që e potencoj drejtori i DPUMM që kontributet mund të jepen edhe përmes sistemit elektronik ne jemi në dijeni se jo të gjithë e kanë atë mundësi që ta bëjnë atë veprim, kështu që e vetmja mundësi që të dalim prej kësaj situatë është të kemi dakordim të përgjithshëm, në të kundërtën bëhen shkelje ligjore për të cilat ekzistojnë edhe sanksione sepse nuk ka mundësi ligjore që në këto rrethana që jemi të mbahen tubime publike, pavarësisht lokaliteteve ku planifikohen ato.

z.Avni Fetahu, theksoi, unë shoh një specifikë sepse mediat elektronike janë duke funksionuar dhe ne po e shohim që shpërndarja e subvencioneve, thirrjet fermerëve po mbahen në këtë sallë, po mbahen trajnime me OJQ të ndryshme të LDK-së nëpër Komunë, andaj krejt ato po bënë të realizohen, e vetëm tubimet publike për këtë propozim Rregullore nuk po bënë, kështu që po shihet qartë se është politike. Shumë mirë e potencoj kolegja znj.Doruntina Hasani se po të kishte vullnet mund të organizohen dhe të mbahen debatet publike nëse veç dëshironi një Rregullore të mirë, nëse dëshironi ta arsyetoni me pandemi ju mundeni ashtu siç po i arsyetoni zgjedhjet.

***Kryesuesi i Kuvendit**, ua tërheq vërejtjen këshilltarëve lidhur me përplasjet verbale mes vete kohë pas kohe si dhe përdorimin e gjuhës jo parlamentare gjatë seancave të Kuvendit, duke jua rikujtuar që nuk lejohen gjëra të tilla dhe që vërejtje të tilla do t'i bëjë publike nga seanca e radhës, madje edhe deri te marrja e masave - përjashtim nga seanca.*

z.Bajram Ajeti, theksoi, nga disa parafolës pati edhe ide të reja rreth mbajtjes së tubimeve publike, mirëpo pa dashur të paragjykoj sepse ne e dimë që LDK është e interesuar që të paktën deri në zgjedhje të shkohet me këta kryetar aktual të fshatrave që i ka dhe që i ka emëruar arbitrarisht, kështu që nuk është edhe ide e keqe ajo që u propozua nga z.Hasan Ajeti që të pezullohet përkohësisht mirëpo po të ishte në nivel transparenca dhe njoftimi i qytetarëve për debatet publike qoftë edhe me teknikat tjera si internet apo forma të ndryshme është e mirëpritur por megjithatë dyshoj në këtë përkushtim të cilin nuk e kemi që të gjithë qytetarët të informohen e që pastaj është çështje e tyre individuale se a do të japin kontributin e tyre.

Kështu që ne mbetemi prapa asaj që të mbahen debatet publike edhe pse jemi në dijeni nga e kaluara se në debatet publike për një akt administrativ të Komunës nuk marrin pjesë as numër i përafërt me këtë që jemi sot në këtë sallë, por që mbetemi prapa asaj që e potencoj edhe drejtori i DA-së që të organizohen sa më shumë debate publike për këtë propozim Rregullore e cila është në interes që të del sa më e trajtuar dhe e shqyrtuar nga qytetarët e pastaj sa më e aprovuar me unifikim në asamblenë e Komunës së Podujevës.

z.Avni Islami, theksoi, konsideroj që debati i deri tanishëm ishte i mirëfilltë dhe konstruktiv andaj nga secili debat dalin edhe frytet. Duke pasë parasysh që deri në një vendim tjetër Qeveria e Republikës së Kosovës ka një vendim sipas të cilit në tubimet publike të mos ketë më tepër se 5 persona, për shkak të pandemisë, andaj edhe nuk e di se si mund të organizohen tubime publike me qytetarë pavarësisht se ne kemi masa mbrojtëse (maska, dezinfektues etj.) mirëpo për tubime publike është vendim i Qeverisë.

Pajtohem me propozimin e këshilltarit z.Hasan Ajeti që të shtyhet kjo çështje deri në një vendim tjetër në mënyrë që debatet publike të zhvillohen në rrethana më normale dhe të organizohen debate

vërtetë të frytshme dhe mirëfillta me qytetarë dhe me ne si këshilltarë të Kuvendit në mënyrë që kur t'i vie radha për votim final të Rregullores në këtë Kuvend të jemi sa më unik, prandaj edhe unë propozoj që të pezullohet kjo procedurë përkatësisht ajo çfarë u diskutua deri tani rreth kësaj çështje. **z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike, theksoi, kemi dy propozime lidhur me këtë çështje, andaj e hedh në votim propozimin që të pezullohet / shtyhet organizimi i diskutimit / debateve publike lidhur me propozim Rregulloren sipas kësaj pike të rendit të ditës, deri sa të krijohen kushtet dhe mundësitë e mbajtjes së debateve publike në lokalitete dhe pjesë tjera të Komunës së Podujevës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi që me 18 vota për, 11 vota kundër, të tjerët nuk morën pjesë në votim, miratohet vënia në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës si dokument. Ndërsa,

Pezullohet / shtyhet në kohë të pacaktuar, deri në një vendim tjetër nga ana e Kuvendit të Komunës, organizimi i diskutimit/debatit publik sipas propozim vendimit për vënie në diskutim publik, për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19 dhe pamundësisë së mbajtjes së tubimeve publike me komunitetet e fshatrave dhe lagjeve urbane, përkatësisht deri në përmirësimin e situatës epidemiologjike dhe krijimit të kushteve për organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike.

3. Propozim Kodi i Etikës për zyrtarët e Komunës së Podujevës

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij dokumenti, ndër të tjera theksoi, në një mënyrë në hyrje të kësaj pike veç diskutuam rreth kësaj pike, e potencuam që është një model Kod i Etikës i përgatitur nga Ministria e Pushtetit Lokal – MPL dhe i dërguar në Komuna dhe të njëjtin e keni paravetës andaj edhe ju ftoj ta votoni dhe të vazhdojmë tutje.

Pra është një ndër draft Kod i Etik, model i cili është sjellë nga MPL në muajin qershor dhe tani e kemi proceduar për shqyrtim dhe miratim në këtë seancë, ndërsa sa i përket asaj që u përmend më herët rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për zyrtarët publik e që është e vërtetë se Gjykata në fjalë ka miratuar një pjesë të këtij Ligji por pjesën tjetër e ka lënë në fuqi, andaj mbetet të shihet se si po vendosni ju si Kuvend.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim propozim Kodin Etik për zyrtarët e Komunës së Podujevës, por gjithnjë duke iu referuar bazës ligjore sepse në qoftë se ne sot e miratojmë këtë Kod dhe i njëjti pastaj del që nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi atëherë është shumë e vërtetë që Ministria e Pushtetit Lokal mund ta revokoj.

Ajo çfarë unë kam vërejtur në propozim Kodin në fjalë ka të bëjë me nenin 33 paragrafi 8 – përbërja e komisionit, sipas të cilit përcaktohet që ky komision të ketë 5 anëtarë (2 nga përbërja e Kuvendit, 1 nga Ekzekutivi i Komunës dhe 2 anëtarë nga radhët e qytetarëve me integritet dhe të njohur publikisht në Komunë) e që nuk përcakton formën dhe procedurën se si zgjidhen këta anëtarët nga radhët e qytetarëve andaj mendoj se është mirë të rregullohet si procedurë se do të zgjidhen këta 2 anëtarë. Pra edhe njëherë, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK e mbështesim n'parim këtë propozim Kod të Etikës, ndërsa në rast se nuk është në harmoni me ligjin atëherë i njëjti mund të revokohet nga ana e MPL.

z.Bajram Ajeti, theksoi, realisht edhe më herët diskutuam rreth këtij dokumenti për të cilin kërkuam që të hiqet nga rendi i ditës, mirëpo tani dëshiroj të shtoj edhe diçka, të mos harrojmë se shkresa e Ministrisë ka qenë më datën 06 shkurt 2020 me numër protokolli 02-129/2 dhe mos të harrojmë që

këto ligje kanë qenë të botuara edhe në Gazetën Zyrtare e që më pastaj me kërkesën e Avokatit të Popullit janë kontestuar këto dy ligje e që pastaj kemi dy Aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese sot nuk janë në fuqi ligjet në fjalë sepse duhet të kalojnë procedimin përmes Kuvendit të Kosovës për plotësuar dhe ndryshuar me qindra nene e paragrafë, posaçërisht neni 2, prandaj mendoj që është mirë ta hetojë / konstatojmë vetë ne e jo një zyrtar i “shkokërdhuar” i Ministrisë përkatëse dhe të mendohet se çdo gjë që bëjnë ata atje e bëjnë drejtë, e që nuk e bëjnë në pajtim me Ligjet dhe Kushtetutën. Kur flas për Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes jam njohës sepse jam edhe ligjërues dhe trajner i Kodit Etik të të drejtave dhe përgjegjësi të nëpunësve civil në institutin e administratës publike. Në neni 3 të këtij propozim Kodi është paragrafi në të cilin thuhet, zyrtar publik përfshinë zyrtarët siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit 06/L-114 për zyrtarët publik, pra në Kod Etik e ke çështjen që e merr këtë Ligj për bazë, ligj i cili nuk është aprovuar dhe faktikisht do t'i nënshtrohet procedimit, andaj për këtë arsye më duket se është shumë e qartë për ata që dëshirojnë prova, fakte dhe të vërteten, por ne kemi të drejtë, dhe do të japim votën kundër për arsye se bie ndesh me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, Aktgjykime të cilat janë ligje e që ligjet duhet të respektohen dhe besoj se është vullnet i të gjithëve.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK do ta përkrahim këtë dokument Kod të etikës për zyrtarët publik, duke qenë në dijeni për rëndësinë e tij duke shpresuar që i njëjti të gjen zbatim në praktikë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalë e hedh në votim propozim Kodin Etik sipas materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 25 vota për, 7 vota kundër, dhe asnjë votë e përmbajtur miratohet Kodi Etik për zyrtarët e Komunës së Podujevës.

z.Bajram Ajeti, nga vendi reagon, të kuptohemi qartë se nuk jemi dhe nuk votuam kundër Kodit Etik, por procedura se si po miratohet është e kundërligjshme

4. Propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së futbollit Kosovar Fadil Vokrri

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse përkatësisht propozimin përkatës, ndër të tjera theksoi, kemi një kërkesë me shkrim nga Komitetit i Sporteve të Krijuesve të Trevës së Llapit për aprovimin e caktimit të lokacionit për vendosjen e Shtatores së Fadil Vokrrit, figurë për të cilën nuk kam çfarë të flasë sepse jemi në dijeni të gjithë se ka qenë dhe mbetet legjendë e sportit të Kosovës por edhe në kohërat më të hershme të ish Jugosllavisë dhe Europës në përgjithësi kështu që secili prej nesh e dimë kush ka qenë dhe çfarë ka bërë andaj edhe nuk kam çfarë të zgjas më shumë.

Këtë propozim e kemi futur në KPF si pikë shtesë në kundër të rendit të ditës dhe e njëjta është rekomanduar për shqyrtim në këtë seancë të Kuvendit, andaj tani është në kompetencë të Kuvendit të Komunës të vendos për caktimin e lokacionit përkatës për vendosjen e Shtatores në fjalë, lokacion i cili në bazë të shqyrtimit të kërkesës nga ana e Ekzekutivit të Komunës është paracaktuar në bulevardin / sheshin e qytetit konkretisht në mesin e parkut në anën e kundërt të objektit të vjetër të Komunës ku aktualisht gjendet një figurë e Unionit European, hapësirë në të cilën do të vendoset Shtatorja e Legjendës së Futbollit Fadil Vokrri, nëse veç miratohet nga ana juaj si Kuvend.

z.Agim Behluli, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim për caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së Futbollit Fadil Vokrri, lokacion i cili konsiderojmë se më i përshtatshmi i mundshëm, megjithëse ka pas propozime edhe për lokacion në magjistrale – rreth rrotullime etj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, kërkesa e Komitetit të Sportit është shumë e drejtë dhe shumë e arsyeshme sepse një figurë e tillë sportive që i ka dhënë shumë sportit vërtetë është emblematike për ne dhe posaçërisht për sportdashësit me theks ata të futbollit, mirëpo lokacioni disi më duket se nuk është ai i qëlluari sepse meriton të jetë një vend më publik si dhe mendoj se ky lokacion është caktuar disi në mënyrë tendencioze ndaj Lëvizjes Vetëvendosje sepse nëse ju kujtohet, posaçërisht Kryesuesit të Kuvendit ka qenë një kërkesë e muajit shkurt 2018 drejtuar Fatmir Gashit Kryesues i Kuvendit të Komunës Grupi i këshilltarëve të LVV-së në Podujevë ka kërkuar që në një mbledhje të radhës të futet në rend të ditës emërtimi i një sheshi në qytetin e Podujevës me emrin Adem Demaçi, përkatësisht pjesa e qytetit buzë lumit Llap që shtrihet nga parku i qytetit deri te kompleksi i banesave “Malësia” që nga qytetarët shfrytëzohet si shëtitore, dhe tani e para, nuk është respektuar Ligji për procedurën e përgjithshme administrative që kësaj kërkesë t’i përgjigjeni kurse tani caktoni të njëjtin lokacion për Fadil Vokrrin të cilin e kam njohur dhe kam ndejt me të dhe ka qenë një njeri vërtetë i këndshëm, ndërsa tani kjo çështje më duket se është një tendencë sepse aty ku ne kemi propozuar që të jetë sheshi/shëtitorja me emërtimin e Adem Demaçit ju po e vendosni shtatoren e Fadil Vokrrit thua që nuk ka vende të tjera qyteti ynë, posaçërisht tani kur është duke u ndërtuar një shesh i madh, madje pse jo që të jetë edhe në sheshin këtu afër, përball Shtatores së Ali Ajetit sepse të Dy-të janë me origjinë nga fshati Sfeçël, mirëpo pse jo edhe varianti në magjistralen Podujevë Prishtinë në mënyrë që Shtatoren e Fadil Vokrrit ta takonin të gjithë, edhe ata që vijnë nga Prishtina por edhe ata që vijnë nga shtetet jashtme dhe të shohin dhe “të përshëndeten me Fadil Vokrrin” në një rre rrotullim i cili vërtetë do të bëhej shumë i bukur, po pse jo edhe tek stadiumi i futbollit e që do të ishte frymëzim për të gjithë sportistët, futbollistët aktual dhe të gjithë ata që do të vijnë në gjeneratat e ardhshme e që do t’ju jepej mundësi që çdo ditë të “takohen me Fadil Vokrrin”, kështu që ne LVV jemi për, mirëpo caktimi i lokacionit po më duket se është paksa tendencioz n’krahësim me kërkesën që kemi bërë ne si grup i këshilltarëve të LVV-së e që është dashur t’i përgjigjeni kësaj kërkesë e pastaj të propozoni lokacionin.

E di që ju me vota mund të bëni ç’të dëshironi mirëpo ka qenë mirë që statuja e Fadil Vokrrit të vendoset në një lokacion më afër publikut sepse fundja në këtë ku po propozohet ka më pak qarkullim të njerëzve. Përndryshe jeni në dijeni se për Fadil Vokrrin ne kemi mbajtur edhe aktivitete, Fadil Vokrri, për ata që nuk e dinë, nga Franca ka qenë edhe ndihmues i Luftës së Kosovës me dhjetëra dhjetëra mijëra mjete financiare, andaj kemi obligim ndaj Tij, mirëpo mendoj se lokacioni i propozuar sot, duke marrë për bazë edhe mos përgjigjen ndaj kërkesës duket e pasinqertë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë parafolësi mu drejtua mua si Kryesues i Kuvendit rreth një kërkesë, ju sqaroj se emërtimi parqeve dhe shesheve si zona të qarkullimit publik është çështje e Drejtorisë përkatëse dhe me atë duhet të merret drejtori përkatës që është edhe detyrë dhe kompetencë ligjore e jo Kryesuesi i Kuvendit.

Në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit, në emrin tim personal dhe shumicës prej këshilltarëve këtu besoj, ju them juve dhe gjithë të tjerëve duke përfshirë edhe qytetarëve ka vende dhe hapësira që për figura qoftë si Ibrahim Rugova qoftë si Adem Demaçi qoftë për Nënë Terezën, etj etj, që të vendosen në mënyrë që t’i madhërojmë, t’i kujtojmë dhe t’i vendosim.

z.Vendenis Lahu, theksoi, meqë u përmend nga Kryesuesi i Kuvendit Drejtoria përkatëse, unë kam qenë te drejtori dhe kam biseduar rreth kësaj çështje pasi që ne kemi paraqitur kërkesën dhe kemi protokolluar më 29 maj 2018, kërkesë për të cilën kemi biseduar me drejtorin i cili më ka thënë se

për çështje të tilla kemi shumë kërkesa por që kjo kërkesë do të shqyrtohet më vonë e që realisht sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative janë 8 ditë kohë për shqyrtimin e kërkesës dhe kthimin e përgjigjes, dhe tani po shohim se ka një kërkesë prej Shoqatës së Komitetit të Sporteve të Komunës së Podujevës rreth një pune afërsisht të njëjtë dhe që Drejtoria përkatëse propozon lokacionin të cilin në LVV e kemi kërkuar më 2018.

Sigurisht që Komuna e Podujevës ka dhënë emra të shquar në fusha të ndryshme e që një prej tyre është edhe sportisti dhe futbollisti i madh Fadil Vokrri, por po ashtu njeri i madh është edhe simboli i rezistencës Kombëtare dhe simboli i identitetit Kombëtar Shqiptar i cili kalon edhe përmasat Shtetërore dhe është nivel Shqiptar dhe Kombi Shqiptar është përtej Kosovës dhe Shqipërisë, deri në Australinë e largët, prandaj më duket e çuditshme dhe e panevojshme që sot në këtë mbledhje të caktohet një lokacion i tillë me të cilin vë në kundërthënie këto dy figura në mënyrë fare të panevojshme, shtuar kësaj që kërkesa ka qenë e paraqitur qysh moti dhe e protokolluar, dhe siç e potencoj edhe kolegu zotëri Ajeti që kemi lokacione tjera të mira dhe të përshtatshme jo vetëm për ikonën e sportit dhe futbollit të Kosovës por edhe për të gjitha figurat tjera të rëndësishme Kombëtare që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e shtetit tonë, prandaj për mendimin tim duhet të jemi të kujdesshëm dhe ta rishqyrtojmë mirë dhe të vendosim të gjithë bashkërisht për një lokacion të duhur dhe të sakt i cili do të na nderonte jo vetëm neve si Kuvend por edhe legjendat ashtu siç e meritojnë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, paska e kemi problem sepse të gjithë po kërkojnë mbështetje politike, LVV ka një propozim për të cilin po kërkon mbështetje, mandej propozimi i LDK-së apo Komitetit të sporteve po ashtu kërkon mbështetje, mirëpo unë nuk e shoh problem sepse Podujeva momentalisht dy shtatore i ka (shtatorja e Ali Ajetit dhe ajo e 4 Heronjve) prandaj ka hapësira dhe sheshe tjera. Nuk e di saktësisht se si quhet ky sheshi ku është propozuar të vendoset Shtatorja e Fadil Vokrrit, por në parim dhe në praktikë në vendet që punohet mirë ashtu siç punohet sheshi aty edhe vendoset Shtatorja andaj është mirë që nëse vendoset Shtatorja është mirë të emërohet edhe sheshi me atë emër sepse sheshet shfrytëzohen nga të gjithë edhe pse jemi ndoshta e vetmja Komunë që nuk i kemi shfrytëzuar sheshet si duhet qoftë për çështje komerciale qoftë për shfrytëzim të qytetarëve, por që tani falë Zotit tani është në ndërtim sheshi i qytetit të Podujevës. Drenasi në një shesh ka 10 shtatore dhe nuk e ka problem këtë çështje edhe pse sikurse edhe te ne edhe në atë Komunë ka parti politike të ndryshme. E shohë të panevojshme të hymë në konfuzitet të figurave mes Adem Demaçit dhe Fadil Vokrrit. Adem Demaçi është më madh sa i përket çështjes së kontributit Kombëtar se sa Fadil Vokrri dhe nuk krahason vlerat dhe sakrificat e tyre në këtë aspekt, por që shtatorja e Fadil Vokrrit e meriton të jetë në Podujevë andaj mos t'ia bëjmë sikurse Prishtina sepse tani mund të ndodh që vie Ramiz Lladrovci bashkë me Bekim Haxhiun dhe e qojnë në Drenas dhe mos të ankohe mi pastaj dhe të thuhet se si ta marrë qeverinë do ta kthejë kënde.

Kur një Komunë nuk i bënë vend ndokujt me vendime, pastaj vendin e bënë tjetër kush dhe nuk ke çfarë ankohesh pastaj edhe pse mund të jemi të pakënaqur kështu që ne PDK e mbështesim vendosjen e Shtatores së Fadil Vokrrit në Podujevë dhe mendojmë që figurat tona Kombëtare dhe artistike mos t'i lejojmë të dalin përtej Kryeqytetit. Po të pyetem unë do të thoja që Adem Demaçi e ka vendin në kryeqytet ku vijnë delegacionet botërore por edhe në Llap sepse edhe shtatorja e Fadil Vokrrit do të vendoset edhe në Prishtinë, mirëpo këtë që po e diskutojmë po e dëshiron Komitetit i sporteve të Llapit e që mendoj se është inspirim për sportistët e rinjë dhe nuk pengon asgjë, kurse nëse diskutojmë rreth vendit se kush e ka më mirë ai apo ky, do të mbetemi pa marrë vendim.

Sa i përket asaj që LVV ka paraqitur kërkesë dhe nuk është sjellë nga Ekzekutivi i Komunës është krejt çështje tjetër dhe është morë të sqarohen akterët përkatës, kurse në rast se dalim me vendim kundër këtij lokacioni asgjë nuk kemi bërë, kështu që ne e përkrahim dhe mendojmë se është mirë të

hiqen ato figurat aktuale që janë (bubërrca, Union European etj) të cilat për kohën kanë qenë të mira sepse nuk kemi pas tjera dhe vetë Kosova ka qenë në një gjendje më të keqe kurse tani jemi në vitin 2021, pra ka hapësirë të mjaftueshme për tu ndarë sheshi në pjesë të ndryshme qoftë edhe për vendosje të Shtatores së Adem Demaçit edhe më në qendër dhe kur do dhe nga kushdo qoftë që vie në Kuvend kërkesa për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit do ta ketë mbështetjen tonë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, më shtyu të marrë fjalën vepra madhore e futbollistit legjendar, ikonës së Llapit dhe gjithë Kosovës Fadil Vokrri, si dhe përveç kësaj më shtyu të marrë fjalën edhe në bazë të kërkesës dhe konsultimeve që kemi pasë me disa prej komunitetit të artistëve të cilët më kanë thënë se sa i përket lokacionit, ky i propozuari është vend dinjitoz edhe në aspektin e sigurisë dhe aspekteve tjerë për dallim nga lokacionet tjera të përmendura më parë.

Përveç kësaj ata kanë edhe një kërkesë sa i përket dukjes së figurës së Fadil Vokrrit të gdhendur në skulpturë sepse në qoftë se duke njëjtë me atë e cila do të vendoset në Prishtinë atëherë cila është logjika që ndokush nga vizitorët e qyteteve tjera të vizitojnë Podujevën kur të njëjtën e kanë në Prishtinë, prandaj kërkesa ishte që figura të bëhet me një pozicion tjetër apo njërën prej mënyrave si është paraqitur në fushë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë rreth kësaj çështje, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë e hedh në votim propozimin për lokacion për vendosje të Shtatores së Fadil Vokrrit, sipas propozimeve të paraqitura nga drejtori i Drejtorisë përkatës në fjalën hyrëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 24 vota për, asnjë votë kundër, dhe 5 vota të përmbajtura u miratua propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së futbollit Fadil Vokrri, sipas propozimit dhe materialit të prezantuar nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

5. Të Ndryshme

z.Avni Islami, theksoi, një ndër mbledhjet e mbajtura para disa muajve ka qenë edhe mbledhja e jashtëzakonshme rreth dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut, breshërit dhe të ngjashme, andaj kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se çka është ndërmarrë deri tani dhe deri ku ka shkuar ky proces për t'iu dalë në ndihmë familjeve të dëmtuara.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, mirëpo meqë nuk është prezent tani nuk po di a të paraqes pyetjen apo jo sepse edhe ashtu nuk po kthehen përgjigjet, megjithatë po e shtroj, shumë studentë dhe nxënës më kanë shkruar rreth çështjes së bursave andaj si pyetje konkrete është se çfarë është bërë rreth bursave që kanë qenë të parapara të ndahen në fillim të këtij viti, e që shpresoj se do t'i përcillet kjo pyetje dhe do të marrë përgjigje.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, kam dy çështje të cilat konsideroj se janë të rëndësishme, dhe atë; 1-njoftimet që lëshohen nga faqja zyrtare e Komunës së Podujevës pas mbledhjeve të Kuvendit të Komunës të cilat janë plotësisht të pasakta dhe në shërbim të politikës, konkretisht njoftimi i lëshuar pas seancës së jashtëzakonshme të thirrur nga opozita me iniciativën time më datë 24.07.2020, ka qenë i pasaktë, dezinformues dhe me qëllim të fshehjes së vërtetës, në njoftim askund nuk thuhet se kush e ka thirrë seancën, arsyet dhe atë çfarë është biseduar nga iniciuesit e seancës, por ka cekur se vetëm çfarë ka fol Ekzekutivi i Komunës dhe mënyra se si ka dalë para qytetarëve është sikur vet pozita e ka thirrë këtë seancë për të diskutuar për dëmet pas reshjeve dhe breshërit, gjë e cila është e ulët dhe e padrejtë sepse faqja zyrtare e Komunës nuk është faqe e partisë në pushtet por është e

institucioneve dhe që duhet të paraqes të vërtetën. Dezinformimet e vazhdueshme kanë pasë për qëllim t'i hutojnë dhe t'i mashtrojnë qytetarët, andaj në këtë rast kërkoj nga Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit të Komunës i cili po vazhdon avazin e vjetër të ish Kryetarit të Komunës që nuk po merre pjesë në mbledhjet e Kuvendit, që të marrë veprimet e nevojshme që të mos ndodh në të ardhmen një dezinformim i tillë, ose të lëshoj komunikatë vetë Kuvendi i Komunës pasi është jo etike dhe e pamoralshme të përsëritet një gjë e tillë, nëse nuk mund të raportohet drejtë të mos raportohet fare, unë e di që ka procesverbal të mbledhjes por që publikohen me shumë vonesa, pra atëherë kur informata e humb rëndësinë nuk duhet të përsëritet fare. Nëse dëshironi të dini për çfarë po foli vetëm shikojeni informatën e lëshuar nga Zyra për marrëdhënie me publikun dhe informim në faqen e Komunës së Podujevës – Facebook më datë 24.07.2020 ora 16:25 dhe mund ta shihni se sa dezinformues është ai njoftim që është bërë.

2-çështje tjetër e rëndësishme dhe që ka të bëjë me një sektorë të rëndësishëm që është ai i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ditë më parë kisha një takim me Shoqatën “Mjedrat e Llapit” për tu informuar saktësisht rreth problemeve dhe me çfarë po ballafaqohet kjo Shoqatë dhe pata mundësinë të informohem se çështja e Drejtorisë në fjalë është shpërfillë dhe fermerët që merren me kultivimin e kësaj kulture bujqësore ndihen të braktisur nga Komuna e Podujevës, për më tepër tash më është bërë e zakonshme që këta fermer të kenë vëmendjen e Komunës vetëm kur është koha e fushatave dhe kur i duhen Komunës për foto-marketing politik. Është për tu habitur se si një Shoqatë me kaq shumë fermer dhe me mbi 1000 hektarë të mbjella me mjedra e që të hyrat për vitin e kaluar kanë qenë mbi 3.5 milion euro nga eksporti në Evropë dhe që këtë vit pritet të jetë mbi 6 milion euro të lihen në mëshirë të fatit nga Komuna duke i lënë pa zyrë ku ata takoheshin mes vete me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe njohurive, ku do t'i takonin fermerët dhe të rinjtë, ku do të udhëzoheshin që të mbronin produktet e veta. Për dallim nga Komuna kësaj Shoqate USAID i ka ndihmuar shumë, madje krejt inventarin e Zyrës së kaluar e kanë pasë donacion kurse zyrtarët komunal të cilët nëpër fushata zgjedhore mburren me të, madje edhe duke e quajtur ari i kuq i Llapit, nuk janë në gjendje t'iu ofrojnë të paktën 1 zyrë. Kjo Shoqatë, nga participimi i fermerëve dhe nga ndihma që iu është dhënë nga USAID ka ekzistuar deri më tani. Po ashtu çështje tjetër është se ata këtë vit mbi 100,000.00€ kanë fituar donacion për mbjelljen e 8 hektarëve me mjedër Delvina e që drejtori i Drejtorisë përkatëse shpeshherë nëpër media po e paraqet si kontribut të Komunës, jo si të shoqatës, andaj këto që i ceka janë çështje të cilat i kam biseduar me Shoqatën e cekur.

Kam disa pyetje konkrete për drejtorin, she atë; -pse nuk konsultoheni me Shoqatën në fjalë që të bëhen pjesë e komisionit për shpërndarjen e subvencioneve për fermer pasi që ata i njohin më mirë fermerët që merren me këtë kulturë, -pse nuk dilni në terren të shikoni se sa punohet me motokultivatorët që i keni shpërndarë para një kohe dhe sa prej tyre janë shitur menjëherë po sa janë dhuruar edhe pse e di që kohëve të fundit drejtori është në terren por për çështje të caktuar e kam fjalën, -pse nuk konsultoheni për kohën e shpërndarjes së subvencioneve që të jetë më e përshtatshme për ata, dhe për fund unë kërkoj nga zyrtarët komunal që t'iu sigurohet një zyrë këtyre fermerëve pasi që janë shumë në numër dhe kanë shumë nevojë për tu takuar dhe konsultuar me njëri tjetrin, fundja nëse shikohet me kujdes del se janë fermerët që angazhojnë më së shumti fuqi punëtore sezonale në sektorin e bujqësisë.

Kryesuesi i Kuvendit, tërheqë vërejtjen parafolësit rreth kohëzgjatjes së diskutimit në këtë pikë dhe njëkohësisht kërkon nga këshilltarët e Kuvendit që të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit në mënyrë që të mos detyrohet pastaj t'ia ndërpres diskutimin ndokujt.

z.Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, theksoi, dëgjova me vëmendje dy parafolësit të cilët paraqiten pyetje dhe çështje tjera rreth DBPZHR.

Sa i përket pyetjes së këshilltarit z.Avni Islami konsideroj se ishte pyetje shumë me vend sepse është paksa shqetësuese që ky vite i ka përcjellë fermerët me kushte klimatike jo të mira sa i përket disa prej kulturave bujqësore, pastaj pandemia etj e që dëmet në bujqësi në territorin e Komunës së Podujevës arrijnë shumën rreth 700,000.00€. Ne menjëherë pas seancës së jashtëzakonshme që është mbajtur rreth kësaj teme kemi marrë hapa konkret që vërtetë t’iu dilet në ndihmë këtyre fermerëve dhe në këtë aspekt dje kam pasë takim me z.Besian Mustafa, Ministër i MBPZHR, pikërisht për këtë çështje dhe përveç një pjese prej rreth 4000.00€ e që është qesharake nëse vazhdohet me shuma të tilla për kompensimin e dëmeve për fermerët ende nuk është filluar me kompensimet tjera, mirëpo shpresoj shumë që në bazë të premtimeve të Ministrit shumë shpejt do të fillohet me kompensimin e dëmeve në Komunën e Podujevës por edhe për Komunitat tjera.

Po ashtu ne si komunë jemi duke shikuar një mundësi buxhetore që vërtetë edhe ne t’iu dalim në ndihmë këtyre fermerëve sepse vërtetë janë të prekur shumë nga dëmet e shkaktuara nga reshjet, ngricat, vërshimet etj. e që jashtëzakonisht meritojnë të përkrahen dhe që menjëherë kemi filluar që konkluzionin e nxjerrë nga aso seancë e jashtëzakonshme, përkatësisht kemi futë një kodë për dëmet në bujqësi për vitet në vijim dhe do ta arrijmë atë besoj edhe me përkrahjen e juve si Kuvend.

Sa i përket çështjeve të ngritura nga parafolësi z.Pajtim Hodolli mund të them asnjë prej tyre nuk qëndrojnë dhe nuk janë të vërteta sepse unë kam një bashkëpunim të shkëlqyer me shoqatën “Mjedra e Llapit”, madje me kryetarin e Shoqatës kam kontakte të vazhdueshme dhe kam marrë opinionet e tyre që dy programet e tyre që kanë qenë, sistemi i ujitjes, dhe që shumë mirë që u përmend edhe donacioni për këta fermerë sepse për herë të parë në Podujevë, në Ballkan mbillet një varietet delmiva, 8 hektarë donacion ky i USAID përmes Shoqatës “Mjedra e Llapit” kurse pjesën me sitëm të ujitjes e ka ndihmuar Komuna e Podujevës, mandej kemi pasë kërkesë nga kjo shoqatë që të ndihmohen me ushqime – plehra për shkak të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, shiu dhe ngricat.

Është e vërtetë se pas rrënimit të ish objektit përkatës ajo shoqatë ka mbete pa zyrë por kemi pas kontakte të vazhdueshme që t’iu gjendet një zyrë sepse e meritojnë ngase vërtetë punojnë shumë, madje ne gjithëherë thirremi në të dhe e kemi si kulturë strategjike dhe se Podujeva njihet si referente për këtë kulturë andaj do të punojmë të gjithë së bashku që të mos i lëmë jashtë por t’iu gjejmë një alternativë e që për momentin nuk ka mundësi. Kështu që për punët që na takojnë si Komunë dhe si DBPZHR n’raport me fermerët edhe jemi duke i marrë parasysh kërkesat e tyre dhe i kemi dërguar të gjitha në institucionet gjegjëse siç është MBPZHR por edhe ne si Komunë do të përpiqemi dhe do të mundohemi bashkërisht me juve si Kuvend dhe si këshilltarë të Kuvendit.

Sa i përket komisionit komunal mund t’ju them se ka punuar mjaft shumë për 3 muaj rrjesht, për secilin fermer ekzistojnë procesverbale dhe jo vetëm për motokultivator por për secilin subvencion që ka dhënë Komuna kemi procesverbale, madje me theks mund t’ju them se asnjë motokultivator nuk është shitur dhe nuk është keqpërdorë, siç e potencoj parafolësi. Pra sinqerisht ju them se komisioni përkatës ka dalë në terren dhe ka bërë verifikimin e të gjitha subvencioneve të ndara nga Komuna e Podujevës.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, më vie keq që sërish më duhet të marr fjalën për problematikën e njëjtë që faqja zyrtare e Komunës së Podujevës nuk duhet t’i shërbej partisë në pushtet sepse duhet të jetë shembull i mirë për qytetarët. Ne veç se ishim dëshmitar për shtyrjen për kohë të pacaktuar të një debati publik me qytetarë, ndërsa kur ishte në vizitë Ministri znj.Vlora Dumoshi, këtu në parkun afër u mbajti një tubim me shumë persona (ndoshta mbi 50) dhe që nuk paraqiti ndonjë problem, dhe përveç kësaj para derës së Komunës Drejtori z.Gëzim Namani dhe disa drejtor të tjerë kanë dalë me mbani distancë me 1.5 m, ndërsa ishin rreth 13 persona ngjitur mes vete, çështje kjo e cila nuk

duhet të vazhdoj të ndodh prej faqes zyrtare të Komunës së Podujevës dhe duhet t'i keni parasysh këto kritika.

z.Avni Fetahu, theksoi, kam vetëm një pyetje lidhur me planin e punës së kuvendit i miratuar këtu bashkërisht e që ka qenë e paraparë që në muajin korrik të sillet Raporti i Auditorit të jashtëm, kurse tani jemi në muajin shtator dhe ende nuk është sjellë. Jemi të vetëdijshëm se jeni të interesuar ta shtyni dhe të vazhgitni këtë çështje mirëpo parregullsitë një ditë duhet të dalin në shesh kështu që urojmë që mos të sillet përmes një seance të jashtëzakonshme por raporti në fjalë të sjellët me kohë brenda afatit kohorë.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolësit, unë veç e kam ngritur këtë çështje dhe besoj që në një seancë të radhës ai Raport do të sjellët gjithësi.

z.Fatmir Rudari, theksoi, dëshiroj të ngriti një çështja e cila paksa mund të jetë edhe teknike, fjala është për pajisjen me kartela identifikuese për këshilltarët e Kuvendit të Komunës, çështje kjo e cila ishte paraparë edhe Kodin Etik i cili u miratua në këtë seancë, po ashtu parashihet edhe me rregullore të punës së kuvendit kështu që ne jemi gatoi në përfundim të mandatit dhe ende nuk jemi pajisur me kartela të identifikimit, andaj ndoshta na nevojitet një gjë e tillë me qëllim që të paraqitemi si asamblistë të këtij Kuvendi.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, e kuptoj që drejtori i DBPZHR është duke dalë në terren, ndoshta edhe koha që jemi në fushatë zgjedhore dhe është e vërtetë se është prej drejtorëve më aktiv në terren dhe nuk e mohoj atë, mirëpo të më thotë mua se nuk është e vërtetë për disa gjëra që i potencova është gjë e ulët për shkak se unë kam mbajtur takim me kryesinë, kryetarin dhe të gjithë anëtarët tjerë të Shoqatës së cekur dhe për këtë çështje unë e bëjë publik shkrimin tim dhe nëse ka diçka të dalin dhe të më demantojnë vetë Shoqata. Sa i përket zyrës ata janë shumë të pakënaqur që nuk jua keni ndarë një zyrë dhe nëse tani dhe nëse tani e lëni deri në dimër sigurisht që jeni në dijeni drejtor se është kohë e vjeljes së mjedrave dhe se koha përfundon. Pra unë jam këtu vetëm për t'i paraqitur shqetësimet e qytetarëve dhe nuk janë fjalë që unë i them sipas dëshirës.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr.01-060/04-0054231/20
Podujevë,
09 shtator 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**